

**Njoftim për përqendrim me të cilin RWA Raiffeisen Ware Austria Handel und Vermögensverwaltung eGen Austri do të fitojë kontrollin mbi RWA Raiffeisen Ware Austria Aktiengesellschaft
(lënda nr. 08-30/2025)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 05.02.2025, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës ka marrë një njoftim për përqendrim që i referohet propozimit për fitimin e kontrollit të pavarur nga **RWA Raiffeisen Ware Austria Handel und Vermögensverwaltung eGen**, me seli të regjistruar në Raiffeisenstrasse 1, 2100 Korneuburg, Austri mbi RWA Raiffeisen Ware Austria Aktiengesellschaft, me seli të regjistruar në Raiffeisenstrasse 1, 2100 Korneuburg, Austri, duke përfshirë shoqëritë e saj të varura.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:

RWA Raiffeisen Ware Austria Handel und Vermögensverwaltung eGen është një kooperativë bujqësore që funksionon si një shoqëri holding. Nuk është vetë aktive ekonomikisht dhe si rrjedhojë nuk realizon shitje.

RWA Raiffeisen Ware Austria Aktiengesellschaft (ose Grupi RWA) është një konglomerat shoqërisht që merren me prodhim, tregti dhe shërbime, kryesisht aktiv në tregtinë me shumicë në fushën e blerjes dhe shitjes në sektorin bujqësor të produkteve bujqësore, mallrave (p.sh. fara, pesticide, plehra, ushqim për kafshë), mallrave të konsumit (veçanërisht materiale ndërtimi dhe produkte për shtëpi dhe kopsht), energji si dhe teknologji bujqësore dhe pjesë rezervë. Gjithashtu, ka një sistem franshize në fushën e teknologjisë bujqësore, si dhe për materialet e ndërtimit dhe tregun e shtëpisë dhe kopshtit (DIY).

Grupi RWA nuk ka shoqëri të varura të regjistruara në Maqedoninë e Veriut, por vitin e kaluar ka realizuar të ardhura në Maqedoninë e Veriut.

Parashtruesi konsideron se tregjet relevante të mallrave për këtë Njoftim mund të përcaktohen si: **tregjet për prodhimin dhe tregtinë me shumicë të ushqimit për kafshë, veçanërisht ushqimit të koncentruar për kafshë dhe tregjet për tregtinë me shumicë të inputeve bujqësore, si fara, mbrojtje të kulturave dhe plehra.**

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim në Komision. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga data e publikimit të këtij njoftimi.

12.02.2025

Shkup